

DES CONSTRUCTION sh.p.k.

STATUTI DHE AKTI I THEMELIMI  
TË  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

DES CONSTRUCTION SHPK

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1

Sot më datë 30/01/2024 sipas kërkesave të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe të Ligjit nr.9723 datë 03.05.2007 ”Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit,i përditësuar krijohet shoqëria tregtare **DES CONSTRUCTION shpk** e cila do të veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, nenet e këtij statuti si dhe aktit bashkëngitur tij.

KREU II

EMRI, STATUTI, SELIA, KOHEZGJATJA

NENI 2

Formohet shoqëria tregëtare e emërtuar **DES CONSTRUCTION sh.p.k.** me themelues;

- Z. **Ariet Malaj** i datëlindjes 03-05-1959, me nr. **ID F90503148E** lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë.
- Z. **Elios Duni** i datëlindjes 11-07-1984, me nr. **ID I40711084P** lindur në Berat dhe banues në Tiranë.

NENI 3

Shoqeria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojë humbje deri në kufirin e kontributit të themeluesëve të saj në kapitalin themeltar.

NENI 4

**Selia e shoqërisë tregëtare private DES CONSTRUCTION shpk, do të jetë në adresën:**  
**Rruga “Tish Dahia”, Kompleksi Kika 2, Komuna e Parisit, Kati I, Tiranë.**

Ajo mund të ketë edhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjensi operative në të gjithë territorin e R.SH. dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vendit.

1  
Rruga “Tish Dahia”, Kompleksi Kika 2, Komuna e Parisit, Kati I, Tiranë.

## **DES CONSTRUCTION sh.p.k.**

### **NENI 5**

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj pa afat.

### **NENI 6**

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje **DES CONSTRUCTION sh.p.k**

### **KREU III**

### **OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

### **NENI 7**

#### **Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë:**

- Shoqëria ka si objekt kryerjen e të gjitha aktivitetave që një kompani me përgjegjësi të kufizuar mund të kryej në përputhje me legjislacionin e Shqiperisë, brënda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqiperisë, përfshirë por pa u kufizuar në :
- Ndërtimë dhe rikonstruksione objektesh të ndryshme (pallate, rrugë, ura etj) prodhim dhe tregtim inertesh dhe lënde drusore. Import-Eksport dhe shitë-blerje mallrash te ndryshme, lënde të para, industriale, makineri pajisje, etj. Si dhe merr përsipër, shërbime mirëmbajtje dhe riparimesh të objekteve industriale, tregtare, publike dhe civile. Nënkontrakte punimesh në ndërtim, armaturë, suvatime, punime hidraulike, elektrike, mekanike, punime hekuri, ndërtim muresh, shtrrim pllakash, lyerje, veshje fasade etj.
- Gjithashtu, shoqeria mund të kryej çdo aktivitet tjeter plotësues dhe ndihmës që ka si qëllim ofrimin e cdo aktiviteti tjeter, në rast se rezultojnë të dobishme dhe/ose të nevojshme për përmbushjen e objektit kryesor, si dhe cdo aktivitet tjeter që konsiderohet fitimprurës dhe në interes të shoqerisë.

### **KAPITALI**

### **NENI 8**

#### **Kapitali themeltar i shoqërisë është 1,000,000 lekë, i ndarë në 2 kuota, dhe zotërohet si më poshtë :**

- Z. **Ariet Dino Malaj** zotëron 1 kuotë të barazvlefshme me 70 % të kuotave, me vlerë 700,000 lekë.  
Z. **Elios Nako Duni** zotëron 1 kuotë të barazvlefshme me 30 % të kuotave, me vlerë 300,000 lekë.

Kuotat e kapitalit themeltar janë të nënshkrueshme dhe të shlyeshme krejtësisht. Çdo kuote i takon e drejta e një vote.

### **NENI 9**

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve, por asnjeherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

Ruga "Tish Dahia", Kompleksi Kika 2, Komuna e Parisit, Kati I, Tiranë.

## **DES CONSTRUCTION sh.p.k.**

### **NENI 10**

Ortakët mundet t'u shesin të tretëve kuotat e tyre të kapitalit pjeserisht ose tërësisht, por pasi tua kenë ofruar për blerje ortakëve brënda shoqërisë me kushte jo më pak të favorshme nga ato që j'u ofrohen të tretëve. Oferta i komunikohet me shkrim ortakëve të cilët kanë të drejtë e parablerjes, e drejtë që duhet ta ushtrojnë brënda 30 ditëve nga data e komunikimit.

### **NENI 11**

Kapitali shoqërisë do të përbëhet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros dhe të tjera të nevojshme të luejtëshme e të paluejtëshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë.

### **NENI 12**

Heqja dore nga shoqëria nuk e liron ortakun nga detyrimet e lindura më parë ndaj shoqërisë. Gjithashtu ai gezon të gjitha të drejtat e lindura para largimit te tij.

## **KREU IV**

### **ORGANET DREJTUESE**

### **NENI 13**

Organet drejtuese të shoqërisë do të janë :

*Ortakët:*

- **Z. Ariet Dino Malaj** me nr. ID F90503148E
- **Z. Elios Nako Duni** me nr. ID I40711084P

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet si më poshtë :

### **ASAMBLEJA**

### **NENI 14**

Asambleja e ortakeve është organi më i lartë vendimor. Ajo mblidhet sa herë e shohin të arsyeshme ortakët, por jo më pakë se dy herë në vit. Asambleja e ortakëve miraton domosdoshmërisht bilancin vjetor të shoqërisë. Asambleja i merr dhe miraton vendimet e ortakëve, përvèc rasteve të parashikuara në statut.

### **NENI 15**

Asambleja vendos për bilancin vjetor, për ndryshimet në statut, shtimin ose pakësimin e kapitalit, për emërimin e organit administrativ, për drejtimet kryesore të veprimtarisë së shoqërisë, për pushimin apo ritjen e veprimtarisë së shoqërisë.

## **DES CONSTRUCTION sh.p.k.**

### **ORGANI ADMINISTRATIV**

#### **NENI 16**

**Administrator i Shoqërisë DES CONSTRUCTION shpk do të jetë :**

- Z. Ariet Dino Malaj me nr ID F90503148E , me afat 5 vjecar, të rinovueshëm në heshtje nëse nuk rrimerret vendim brënda një muaji pas datës së mbylljes së afatit 5 vjeçar.**

#### **NENI 17**

Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë në mardhënie me të tretët përmbrashjen e aktivitetit të saj në përputhje me objektin e shoqërisë të shprehur në nenin 7 të këtij statuti.

Organi Administrativ është kompetent për :

- të miratuar planet dhe bilancet periodike mujore dhe tre mujore;
- të propozuar strukturën e aparatit të shoqërisë;
- të marr në punë persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta;
- të propozuar rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme (të vecanta ), ndarjen e fitimit, etj. ;
- të përfaqësuar apo emëruar përfaqësues në cështje gjyqësore që mund të ketë shoqëria;
- të përfaqësuar shoqërinë në rregjistrin e pronës sipas Nenit 18 të këtij statuti.

### **KREU V**

### **KUSHTET EKONOMIKE**

#### **NENI 18**

Shoqeria eshte pronare, perdonuese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo vepron ne regjistrin e prones si cdo person tjeter juridik ne Shqiperi, mund te bleje, te shese, te jape ne perdonim, te ngarkoje me barre per detyrime ndaj te treteve ose per kredi bankare, etj.

#### **NENI 19**

Shoqëria ka llogaritë e saj rrjedhëse, si dhe librin e saj të llogarive në bazë të kërkesave të ligjit për kontabilitetin e dispozitave të tjera fiskale. Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksionet financiare do të kryhen në bazë të kritereve të caktuara nga Banka e Shqipërisë.

#### **NENI 20**

Veprimet ekonomiko-financiare të shoqërisë nisin vitin e parë në momentin e rregjistrit të organet tatimore, ndërsa vitet e tjera në 1 Janar dhe mbyllen në 31 Dhjetor të cdo viti.

Në çdo fund periudhe ushtrimore 1 Janar – 31 Dhjetor, hartohet dhe dorëzohet sipas ligjeve në fuqi bilanci vjetor kontabël. Brënda afateve mujore, tremujore apo gjashtëmuajore pregetiten dhe i dorëzohen Administratorit situacionet dhe pasqyrat financiare periodike. Bilancet periodike ( mujore, tremujore e gjashtëmuajore) miratohen e nënshkruhen nga

- Rruga "Tish Dahia", Kompleksi Kika 2, Komuna e Parisit, Kati I, Tiranë.

## **DES CONSTRUCTION sh.p.k.**

Administratori e më pas ratifikohen në asamblene e radhes. Bilancet vjetore miratohen nga asambleja dhe nënshkruhen nga administratorët.

### **NENI 21**

Me daljen e rezultatit ekonomik të shoqërisë likujdohen të gjitha detyrimet dhe llogaritet e hiqet fondi i rezervës ligjore, sipas vendimeve të asamblesë, në përputhje dhe në zbatim të legjislacionit Shqipëtar.

Fitimi neto, pas likujdimeve të realizuar nga shoqëria, i mbetet në përdorim ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë, me opsonet të tërhiqet ose të riinvestohet në shoqërinë  
**DES CONSTRUCTION shpk.**

### **KREU VI**

### **MARËDHËNIET E PUNËS**

### **NENI 22**

Mardhëniet e punës në këtë shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për cështjet që nuk parashikohen në to zbatohen dispozitat e Kodit të Punës në R.Sh. Mosmarveshjet e punonjësve me shoqerinë do të zgjidhen në gjykatën shqiptare. Punonjësit e emëruar nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit të realizuar nga shoqeria gjatë aktivitetit të saj, nëse në kontratë nuk është parashikuar ndryshe. Për punën e kryer punonjësit marrin pagë siç është parashikuar në kontratë.

### **KREU VII**

### **NENI 23**

Veprimtaria e shoqërisë pushon me vendim të asamblesë për shkakë se :

- veprimtaria rezulton negative;
- ka pamundësi veprimi;
- kërkohet të shpërndahet me vullnetin e lirë të ortakëve;
- do të riorganizohet në një formë tjeter.

### **NENI 24**

Në kushtet e Nenit 23 të këtij statuti asambleja cakton një ose më shumë likuidatorë të cilët marrin në dorë drejtimin e shoqërisë duke kryer gjithë veprimet e likuidimit të saj, duke likuuar ne radhë të parë detyrimet ndaj shtetit e më pas ndaj te tretëve. Në rastin e tepricës së kapitalit të shoqërisë me përfundimin e likuidimit, kjo i shpërndahet ortakut, ndërsa në rastin e pamjaftueshmërisë së kapitalit ortaku është i detyruar të derdhë kuotat e tyre deri në nivelin e kuotave të kapitalit themeltar.

### **DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

### **NENI 25**

Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij statuti dhe aktit bashkëlidhur dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin ne Qëndrën Kombëtare të Rregjistrimit në Tiranë.



Rruga "Tish Dahia", Kompleksi Kika 2, Komuna e Parisit, Kati I, Tiranë.



## **DES CONSTRUCTION sh.p.k.**

### **NENI 26**

Për sa nuk është shprehur në këtë statut i referohet plotësimi me që do të bëjë asambleja si dhe ligjeve të vecanta në të cilat është referuar hartimi i këtij statuti.

Ndryshimet dhe plotësimet e këtij statuti bëhen në të njëjtën mënyrë e procedurë me të cilën nxiret vetë statuti.

### **NENI 27**

Ky statut u përpilua në prani të ortakëve duke shprehur vullnetin e tyre të lirë.

Ai u përpilua në gjashtë kopje me fuqi të barabartë secila për t'u depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit Tiranë, në Zyrën e Tatim -Taksave dhe një kopje mbetet në dokumentacionin baze te Shoqerise DES CONSTRUCTION shpk.Të dy ortakët paisen me nga një kopje origjinale.

### **O R T A K ÈT**

#### **E THEMELIMIT TË SHOQËRISË DES CONSTRUCTION shpk**

**Ariet Dino MALAJ**

**Elios Nako DUNI**